V E N D I M
Nr.606, datë 25.9.1998

PËR ADMINISTRIMIN E DHURIMEVE FINANCIARE E MATERIALE NGA PERSONA FIZIKË E JURIDIKË, VENDAS A TË HUAJ PËR INSTITUCIONET E DËMTUARA NË NGJARJET E 13 DHE 14 SHTATORIT

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhurimet financiare nga persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj, për përballimin e dëmeve të pësuara në aparatin e Këshillit të Ministrave dhe në institucionet e tjera shtetërore, për shkak të veprimeve të dhunshme e të armatosura të pjesëmarrësve në ngjarjet e datave 13 dhe 14 shtator të vitit 1998, të depozitohen në dy llogari bankare të posaçme, përkatësisht në lekë dhe në valutë.

2. Përdorimi i dhurimeve të depozituara, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimet publike, bëhet me miratimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose nga personi i autorizuar prej tij. Dhurimet financiare janë tërësisht të përdorshme nga institucioni përfitues, jashtë fondeve limit të kushtëzuara.

3. Numrat e llogarive bankare, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhen publike nëpërmjet mjeteve të informacionit publik.

4. Dhurimet materiale të administrohen në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi, për miradministrimin e vlerave materiale e monetare dhe të përdoren me miratimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose personit të autorizuar prej tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano